



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

24 -12- 2009

Prishtinë / Pristina

Nr. 1362-09



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 63.11, 74.8, 74.9 dhe 76.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe duke u mbështetur në vendimin e KZAP-it A nr. 508/2009 të datës 19.12.2009, vendimin e KQZ-së të datës 22.12.2009 për përsëritjen e votimit të Zgjedhjeve të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave në Prizren dhe Lipjan, si dhe rekomandimit të KZAP-it sipas vendimit A nr. 508/2009 të datës 19.12.2009 për ndërrimin e anëtarëve të KVV-ve që kanë shërbyer në VV në këto komuna, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 23.12.2009 nxjerrë këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e anëtarëve të KVV-ve për Zgjedhjet e përsëritura të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave në Komunën e Prizrenit dhe Lipjanit

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton rekomandimin e KZAP-it sipas vendimit A nr. 508/2009 të datës 19.12.2009 për ndërrimin e të gjithë anëtarëve të KVV-ve që kanë shërbyer në vendvotimet në Komunën e Prizrenit dhe Lipjanit në procesin e zgjedhjeve të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave të mbajtur me 13 dhjetor 2009.
- II. Të gjithë anëtarët e KVV-ve si në pikën I të këtij vendimi përjashtohen nga pjesëmarrja në KVV në zgjedhjet e përsëritura të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave në Prizren dhe Lipjan.
- III. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së që përmes Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) në Komunën e Prizrenit dhe Lipjanit të siguroj zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi me 23 dhjetor 2009.

Prishtinë, 23.12.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve